



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 06, datë 17.05.2019

PËR

**MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË NISMËS PËR HARTIMIN E PLANIT KOMBËTAR
SEKTORIAL NË FUSHËN E MENAXHIMIT TË MBETJEVE TË NGURTA**

Në mbështetje të neneve 7, 10, 17 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 881, datë 14.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit”, si dhe të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrisë së Infrastrukturës së Energjisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e dokumentit të Nismës për hartimin e Planit Kombëtar Sektorial në fushën e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta, (PKS-MMN), i cili përmban:
 - a. analizën, e cila përcakton qëllimin dhe nevojën për hartim ose rishqyrtim të dokumentit të planifikimit;
 - b. kufijtë e territorit të Republikës së Shqipërisë që mbulon dokumenti i planifikimit;
 - c. listën e dokumenteve përbërës të PKS-së;
 - d. ekspertët (fushat e ekspertizës) që do të përbëjnë grupin e punës, hartues të PKS-së;
 - e. planin e veprimeve për hartimin e dokumentit të PKS-së;
 - f. buxhetin për hartimin e PKS-së;
2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, të drejtojnë punën për hartimin e PKS-MMN, dhe të kryejnë procesin e bashkërendimit dhe këshillimit, me të gjitha autoritetet e planifikimit dhe palët e interesuara.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA

